

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16 dhe 83/18), dhe duke vepruar sipas njoftimit të përqendrimit të parashtruar nga Sava Pozavarovalnica, d.d., me seli në rr. Dunajska cesta nr.56, Lubjanë, Republika e Sllovenisë, nëpërmjet personit të autorizuar Daniela Todorovska, Avokate nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 29.03.2023, solli

AKTVENDIM

Vërtetohet se përqendrimi që i referohet fitimit të kontrollit të plotë individual nga Sava Pozavarovalnica, d.d., me seli në rr. Dunajska cesta nr.56, Lubjanë, Republika e Sllovenisë mbi Shoqërinë për projektimin dhe inxhinierinë e sistemeve të informacionit Application Softvvare Partner d.o.o. Beograd. (Application Software Partner d.o.o. Beograd), me seli në Bul. Krala Aleksandra 17, Beograd, Republika e Serbisë, nëpërmjet shitblerjes së pjesëve, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Parashtruesi i njoftimit të përqendrimit obligohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksë administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbardimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje me nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës më 22.02.2023, e plotësuar më 10.03.2023, te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) është dorëzuar një njoftim i përqendrimit nga Sava Pozavarovalnica, d.d., me seli në rr. Dunajska cesta nr.56, Lubjanë, Republika e Sllovenisë, me të cilin Sava Pozavarovalnica, d.d., do të fitojë kontroll të plotë individual mbi Shoqërinë për projektimin dhe inxhinierinë e sistemeve të informacionit

Application Software Partner d.o.o. Beograd. (Application Software Partner d.o.o. Beograd), me seli në Bul. Krala Aleksandra 17, Beograd, Republika e Serbisë, nëpërmjet shitblerjes së pjesëve.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin e Përqendrimit, shtesave dhe bashkëngjitjeve në të, përcaktoi si më poshtë:

Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

Pozavarovalnica Sava, d.d. është shoqëri me objekt të punës - risigurimit, prania e së cilës në Republikën e Maqedonisë së Veriut arrihet përmes: risigurimi, prania e së cilës në Republikën e Maqedonisë së Veriut realizohet përmes:

- Shoqëria për Menaxhimin e Fondeve Pensionale të Detyrueshme dhe Vullnetare Sava- Shoqëri Pensionale AD Shkup, me qendër në Bul. Nënë Tereza Nr. 1, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, veprimtaria kryesore e së cilës është veprimtaria e menaxhimit të fondeve. Sipas statutit të shoqërisë, subjekti i operimit organizohet si krijimi dhe menaxhimi i fondeve të hapura të detyrueshme dhe vullnetare të pensioneve dhe prezantimin e tyre te palët e treta, si dhe aktivitete të tjera në lidhje me menaxhimin e fondeve pensionale;

- Sava Osiguruvanje A.D. Shkup, me seli në Rr. Zagrebska nr. 28A, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, aktiviteti kryesor i të cilit është sigurimi jo-jetësor me subjekt operimi në fushën e sigurimit të automjeteve, sigurimit të pronës, sigurimit shëndetësor të udhëtimit, sigurimit të aksidenteve, sigurimi shëndetësor vullnetar, sigurimi i biçikletave dhe çiklistëve, sigurimi shëndetësor i kafshëve shtëpiake dhe sigurimi i korporatave;

-Shoqëria për ekzaminimin teknik të automjeteve, sigurimin jo-jetësor të mjeteve motorike Sava Stejshn SHPKNJP Shkup ME SELI në rR. Zagrebska nr. 28B-lokal 20, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, aktiviteti kryesor i të cilit është ekzaminimi teknik dhe analiza nëpërmjet shërbimeve për inspektimin teknik të automjeteve, sigurimin jo-jetës: automjetet motorike, pronën, bujqësinë, transportin, pasagjerin, sigurimin shëndetësor, sigurimin e përgjegjësisë, shërbimi i automjeteve, si dhe raportimi, vlerësimi dhe likuidimi i dëmeve.

Shoqata për Projektimin dhe Inxhinierinë e Sistemeve të Informacionit Application Software Partner d.o.o. është një shoqëri për kryerjen e projektimit, dizajnit, zbatimit, futjen dhe mirëmbajtjen e sistemeve të informacionit, dhe krahas këtij aktiviteti bazë, shoqëria merret gjithashtu me konsultime në fushën e ndërtimit të sistemeve komplekse të informacionit, aplikimit të teknologjive të informacionit dhe shitjes së produkteve të Microsoft, të gjitha në territorin e Republikës së Serbisë.

Shoqëria për Projektim dhe Inxhinieri të Sistemeve të Informacionit Application Software Partner d.o.o nuk ka persona juridikë të lidhur dhe as nuk ka gjeneruar të ardhura në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e*

rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij , veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KRYETAR
I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
Prof. Dr. Владимир Наумовски